



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



Për: Zyra Kombëtare e Auditimit

Nga: Komuna Ferizaj

Nr.	Gjetja/Titulli	Rekomandimi	Njësia përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit/zyrtarët përgjegjës	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Koha/Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Vërejtje
1	Koha e përfundimit të projektit	<p>1. Të bëjnë planifikimin e duhur për ndërtimin e rrugëve duke bërë vlerësimet dhe parapërgatitjet e nevojshme rreth çështjeve pronësore për të siguruar menaxhimin më të mirë të procesit</p> <p>1.1 Aktivitetet e prokurimit të fillojnë në kohën më të mirë të mundshme në mënyrë që kontratat e ndërtimit të rrugëve të zbatohen pa ndërprerje të panevojshme;</p>	<p>1.Njësia përgjegjëse është Drejtoria e Infrastrukturës</p> <p>1.1.Njësia përgjegjëse është:</p> <p>a)Nëse kërkesën për shpallje të tenderit e ka bërë njësia kërkuuese (p.sh. drejtoria e infrastrukturës) sipas planit të prokurimit, përgjegjëse është zyra e prokurimit.</p> <p>b)Nëse të gjitha procedurat janë zhvilluar sipas planifikimit (p.sh. njësia kërkuuese dhe zyra e prokurimit) atëherë vonesat do të ndodhin për shkak të procedurave në KRPP ose OSHP.</p>	<p>1.Drejtorja e Infrastruktures do të mundohet t'i respektoj rekomandimet e ZKA, duke inicuar projektet e reja pas zgjidhjes së problemeve pronësore.</p> <p>1.1 Drejtoria e infrastrukturës do të angazhohet në respektimin e planit të prokurimit duke kërkuar në zyrën e prokurimit fillimin e procedurave tenderuese me kohë.</p>	<p>Periudha e ardhshme e investimeve</p>	<p>Në rastin konkret (projektet e audituara), kanë qenë të planifikuara dhe të shpallura si projekte tre vjeçare, që nga praktikat e deritanishme është tentuar që projektet të përfundojnë brenda 36 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.</p> <p>Në projektet që ka investuar Ministria e Infrastrukturës, buxhetimi ka qenë i varur nga Ministria dhe pavarësisht se ndonjë projekt mund të përfundojë ose do të duhej të përfundojë më herët apo më vonë, buxhetimi është faktori kryesor që definojnë përfundimin e projektit.</p> <p>Nga auditimet që kemi pasur nga niveli qendror rekomandimet e tyre ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të respektohet afati i përfundimit të kontratës, - Të mos detyrohet kompania të punoj nëse nuk ka mjete për pagesë

2	Buxhetimi, kostoja dhe ndryshimi i çmimit në pozicione të ngjashme por në oferta të ndryshme	2. Të sigurojnë buxhetim të mjaftueshëm të fondeve në mënyrë që projektet të realizohen brenda afateve kohore optimale.	2.Njësia përgjegjëse është Drejtoria e Infrastrukturës.	2.Drejtorja e infrastrukturës do të angazhohet në respektimin e planit të përfundimit të projekteve dhe planifikimet buxhetore.	Periudha e ardhshme e investimeve	Në rastin konkret (projektet e audituara), përgjegjëse është Ministria e Infrastrukturës, sipas memorandumit të nënshkruar me Komunën e Ferizajt. Çmimin e pozicionit e përcakton oferta sipas rregullave dhe ligjeve të prokurimit.
3	Standardizimi i projektimit të rrugëve	3. Të sigurojnë rregulla për kriteret teknike për projektim, ndërtim dhe rekonstruktimin për secilën kategori të rrugëve; 3.1 Ministria e infrastrukturës në bashkëpunim me palët relevante të iniciojë procesin rreth unifikimit dhe vendosjes në funksion të standardeve të aplikueshme për ndërtimin e rrugëve në Kosovë; 3.2 Të planifikohet dhe të kryhet analizë e kosto-përfitimit përfshirë studimin e fizibilitetit për çdo projekt të ndërtimit të rrugëve, në bazë të së cilit përcaktohet se në cilat projekte duhet investuar dhe cilat janë me prioritet; 3.3 Projektet kryesore të hartohen për secilin projekt bazuar në standarde unike të ndërtimit në mënyrë që rrugët e tipit/modelit të njëjtë të mos kenë dallime në dizajn dhe strukturë;	3.Njësia përgjegjëse është Ministria e Infrastrukturës dhe Drejtoria e Infrastrukturës	3.Drejtorja e infrastrukturës do të analizoj mundësitë ligjore që studimi i fizibilitetit të përfshihet në kuadër të tenderit të projektimit që do të shpallet gjatë vitit të ardhshëm, pasi Komuna e Ferizajt nuk ka staf të mjaftueshëm për angazhim në këtë fazë të planifikimit.	Periudha e ardhshme e investimeve	Standardizimi dhe unifikimi është kompetencë e nivelit qendror, ndërsa respektimi i tyre është obligim ligjor nga të gjitha institucionet. Studimi i fizibilitetit është një fazë e cila duhet të respektohet por që ka një kosto (nëse tenderohet) ose duhet të ketë staf i cili do të merret me këtë fazë të planifikimit. Në komunën e Ferizajt, në drejtorinë e infrastrukturës e cila merret me menaxhimin e investimeve kapitale, stafi nuk plotëson kapacitetet as për së afërmi për shkak të numrit të kufizuar të punëtorëve nga niveli qendror.

4	Kontrolli i cilësisë së punimeve	4. Të sigurojnë organizim dhe menaxhim adekuat të kontrollit të cilësisë gjatë ndërtimit të rrugëve, për këtë të analizohen/përdoren praktikat më të mira, ku autoritetet kontraktuese marrin përgjegjësinë rreth organizimit dhe sigurimit të cilësisë;	4. Njësia përgjegjëse është Drejtoria e Infrastrukturës dhe zyra e prokurimit	Do të organizojmë takime me zyrën e prokurimit për të shqyrtuar mundësinë e moslejimit të lidhjes së kontratave me operatorë të papërgjegjshëm duke respektuar ligjin si dhe të respektohen vërejtjet e shqiptuara nga menaxherët e kontratave.	Periudha e ardhshme e investimeve	<p>Kjo arrihet përmes zyrës së prokurimit në bashkëpunim me drejtorinë e infrastrukturës.</p> <p>Zyra e prokurimit të ketë kujdes në kushtet e tenderit (mos t'i jepet mundësia që një kompanie fillestare të ofertojë në projekte madhore). Të merr për bazë vërejtjet me shkrim që i shqiptojnë menaxherët e kontratave. Të futë në listë të zezë kompanitë e papërgjegjshme.</p> <p>Drejtorja e infrastrukturës bashkë me zyrën e prokurimit, pas nënshkrimit të kontratës duhet të kërkojnë nga operatorët ekonomik që të prezantojnë të gjitha kapacitetet (stafin, makineritë etj.) që i ka paraqitur në dokumentacionin e tij gjatë fazës së tenderimit. Nëse do të ketë mospërputhje të merren masat sipas ligjeve në fuqi.</p>
---	----------------------------------	--	---	---	-----------------------------------	---

5	Pajisja paraprake me dokumentacionin e nevojshëm	5. Të sigurohen që gjatë ndërtimit të rrugëve zbatohen kërkesat ligjore rreth vlerësimit të ndikimit në mjedis, lejes ndërtimore të rrugëve, aspektin buxhetor si dhe plotësimin e kërkesave që dalin nga Programi për Investime Publike. Po ashtu, të ndërmarrën inspektime të rregullta gjatë procesit të ndërtimit të rrugëve dhe në rast të ndryshimeve në projekt të merren pëlqimet paraprake të nevojshme.	5. Njësia përgjegjëse është Drejtoria e Infrastrukturës dhe Drejtoria e Urbanizmit	Do të organizojmë takime me drejtorinë e urbanizmit dhe të bashkëpunojmë në respektimin e planeve dhe hartave zonale të cilat janë fuqi.	Periudha e ardhshme e investimeve	Pajisja me dokumentacionin paraprak për secilin projekt është e domosdoshëm. Në komunën e Ferizajt, në drejtorinë e infrastrukturës dhe drejtorinë e urbanizmit ka mungesë të stafit sidomos atij profesional.
---	--	---	--	--	-----------------------------------	---